



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

**Kryetarja e Komunës**

**01nr \_\_\_\_\_**

**Dt: 20.04.2015**

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58. a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03L-040, nenit 8,9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, si dhe në harmoni me rekomandimin e Komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport i dt: 03.03.2015 për mbështetje financiare të Klubit basketbollistik me karroca “Vllaznimi” nga Gjakova, me dt: 20.04.2015 e miraton këtë:

**V E N D I M**

**I.** Miratohet kërkesa e Klubit basketbollistik me karroca “Vllaznimi” nga Gjakova nr. 10-400-15008 e dt: 20.02.2015 për subvencionimin e një pjese të shpenzimeve të këtij klubi për mbulimin e shpenzimeve për kampionatin e Kosovës në basketboll, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 500.00 € .

**II.** Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 500.00€, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport dhe bartjen e këtyre mjeteve në konton e z. Islam Kasumaj-“Vllaznimi” KBK nr 1402000001774744 Banka Ekonomike .

**III.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**CO:** - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport  
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa  
- Z. Islam Kasumaj , rr. “Lek Dukagjini”nr.162, Gjakovë  
- Arkivit

**Kryetarja e Komunës**

**Znj. Mimoza Kusari-Lila**